

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
DEPARTAMENTI I TERMOENERGJETIKËS DHE TERMOTEKNIKËS**



PUNIM DIPLOME MASTER

Mentori:
Prof. Asoc. Dr. Xhevat BERISHA

Kandidati:
Drin SHAHINI

Prishtinë, 2018

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
DEPARTAMENTI I TERMOENERGJETIKËS DHE TERMOTEKNIKËS**



PUNIM DIPLOME MASTER

**ANALIZA E EFIKASITETIT TË NJËSIVE TË TERMOCENTRALIT “KOSOVA B”
PARA DHE PAS INSTALIMIT TË KOGJENERIMIT**

Mentori:
Prof. Asoc. Dr. Xhevat BERISHA

Kandidati:
Drin SHAHINI

Prishtinë, 2018

**UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF MECHANICAL ENGINEERING
DEPARTMENT OF THERMAL ENERGETICS AND THERMAL TECHNICS**



MASTER’S THESIS DIPLOMA

**THERMAL POWER PLANT “KOSOVO B” UNITS EFFICIENCY ANALYSIS
BEFORE AND AFTER INSTALLATION OF COGENERATION**

Mentor:
Prof. Asoc. Dr. Xhevat BERISHA

Candidate:
Drin SHAHINI

Pristina, 2018

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| 1. Hyrje | 7 |
| 2. Bazat e kogjenerimit..... | 8 |
| 2.1. Koncepti i kogjenerimit | 8 |
| 2.2. Variantet teknike të kogjenerimit | 10 |
| 2.3. Sistemi i kogjenerimit të turbinës me avull | 10 |
| 2.4. Sistemi i kogjenerimit të turbinës me gaz..... | 12 |
| 2.5. Sistemi i kogjenerimit të motorëve me djegie të brendshëm..... | 14 |
| 2.6. Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e kogjenerimit..... | 15 |
| 2.6.1. Përputhja e ngarkesës elektrike bazë..... | 15 |
| 2.6.2. Përputhja e ngarkesës termike bazë..... | 15 |
| 2.6.3. Përputhja e ngarkesës elektrike | 15 |
| 2.6.4. Përputhja e ngarkesës termike | 16 |
| 2.7. Parametrat tipike të performancës së kogjenerimit..... | 16 |
| 2.8. Meritat relative të sistemeve të kogjenerimit..... | 17 |
| 2.9. Politikat e shpërndarjes së energjisë | 18 |
| 2.10. Termocentrali Kosova B dhe sistemi i kogjenerimit në termocentralin Kosova B | 19 |
| 2.10.1. Historiku i shkurt i investimeve në Termocentralin Kosova B | 19 |
| 2.10.2. Projekti i kogjenerimit në termocentralin Kosova B | 21 |
| 2.10.3. Diagramet referente të bilancit termik për mënyrën e operimit të kondensimit..... | 22 |
| 2.10.4. Shqyrtimi nga aspekti termodinamik i tre rasteve për furnizimin me ngrohje qendrore..... | 23 |
| 2.10.5. Shqyrtimi nga aspekti i dizajnit të turbinës i tre rasteve për furnizimin me ngrohje qendrore | 25 |
| 2.10.6. Përmbledhjet e shqyrtimeve nga aspekti termodinamik dhe të dizajnit të turbinës..... | 26 |
| 3. Parametrat projektues dhe punues të termocentralit Kosova B dhe të sistemit të kogjenerimit..... | 33 |
| 3.1. Parametrat projektues dhe punues të termocentralit Kosova B para instalimit të kogjenerimit | 33 |
| 3.2. Parametrat projektues dhe punues të termocentralit Kosova B pas instalimit të kogjenerimit..... | 40 |
| 4. Llogaritja e rendimentit të bllokut të termocentralit Kosova B para instalimit të sistemit të kogjenerimit | 46 |
| 4.1. Rendimenti i termocentralit Kosova B për ngarkesë projektuese minimale me fuqi 189 MW | 46 |
| 4.2. Rendimenti i termocentralit Kosova B për ngarkesë projektuese me fuqi 252 MW | 49 |
| 4.3. Rendimenti i termocentralit Kosova B për ngarkesë projektuese nominale me fuqi 315 MW | 51 |
| 4.4. Rendimenti i termocentralit Kosova B për ngarkesë projektuese maksimale me fuqi 339 MW | 53 |

| | | |
|-----------|---|-----------|
| 4.5. | Rendimenti i termocentralit Kosova B për fuqi 230 MW për parametra të ndryshëm nga ai projektuese ..55 | 55 |
| 4.6. | Rendimenti i termocentralit Kosova B për fuqi 295 MW për parametra të ndryshëm nga ai projektuese ..57 | 57 |
| 4.7. | Përmbledhje e rezultateve të llogaritjes së rendimentit të termocentralit Kosova B para instalimit të sistemit të kogjenerimit.....59 | 59 |
| 5. | Llogaritja e rendimentit të bllokut të termocentralit Kosova B pas instalimit të sistemit të kogjenerimit | 60 |
| 5.1. | Rendimenti i termocentralit Kosova B për ngarkesë projektuese minimale me fuqi 189 MW energji elektrike dhe 70 MW energji termike | 60 |
| 5.2. | Rendimenti i termocentralit Kosova B për ngarkesë projektuese nominale me fuqi 315 MW energji elektrike dhe 70 MW energji termike | 62 |
| 5.3. | Rendimenti i termocentralit Kosova B për ngarkesë punuese të ndryshëm nga ai projektues me fuqi 232 MW energji elektrike dhe 48 MW energji termike..... | 64 |
| 5.4. | Rendimenti i termocentralit Kosova B për ngarkesë punuese të ndryshëm nga ai projektues me fuqi 284 MW energji elektrike dhe 52.3 MW energji termike..... | 66 |
| 5.5. | Përmbledhje e rezultateve të llogaritjes së rendimentit të termocentralit Kosova B pas instalimit të sistemit të kogjenerimit..... | 68 |
| 6. | Menaxhimi i procesit gjatë operimit me sistemin e kogjenerimit në termocentralin Kosova B | 69 |
| 6.1. | Strategjia e sistemit automatik..... | 69 |
| 6.1.1. | Mënyrat e operimit AUTOMATIKE – MANUALE..... | 72 |
| 6.1.2. | Termet themelore në lidhje me kontrolluesin..... | 72 |
| 6.1.3. | Struktura e kontrollit të njësisë në tërësi | 72 |
| 6.2. | Marrja e avullit nga turbinat e termocentralit B1 dhe B2 | 74 |
| 6.2.1. | Ndërlidhja në mes të sistemit të kontrollit të turbinës (DCS) dhe kontrollit të ndërtesës së dërgimit (HES)..... | 74 |
| 6.2.2. | Shkëmbimi i sinjaleve | 74 |
| 6.2.3. | Mënyrat e operimit të turbinës / këmbyesit të nxehtësisë..... | 76 |
| 6.2.4. | Flegra izoluese në tubacionin lidhës të avullit me presion të ulët ndërmjet bllokut B1 dhe B2 00RG15 S001..... | 79 |
| 6.2.5. | Flegra izoluese në tubacionin lidhës të kondenzatit ndërmjet bllokut B1 dhe B2 00RP25 S001..... | 79 |
| 6.2.6. | Sistemi i kthimit të kondenzatit..... | 79 |
| 6.2.6.1. | Mbajta nën kontroll të presionit të sistemit të kondenzatit të blloku B1 01RP30P001C | 79 |
| 6.2.6.2. | Mbajta nën kontroll të presionit të sistemit të kondenzatit të blloku B2 02RPP001C | 81 |
| 6.3. | Gjenerimi i nxehtësisë në stacionin e pranimit të nxehtësisë (HES) | 82 |
| 6.3.1. | Mënyrat e operimit të këmbyesve të nxehtësisë..... | 82 |

| | |
|---------------------------|-----------|
| 7. Përfundimi..... | 84 |
| 8. Literatura..... | 85 |

1. Hyrje

Pas kërkesave të mëdha të qytetit të Prishtinës për ngrohje qendrore gjatë periudhës së dimrit në njërin anë dhe në anën tjetër duke parë pamundësinë e ngrohjes qendrore të qytetit TERMOKOS për të furnizuar me ngrohje qytetin e Prishtinës, lind nevoja e ringjalljes së projektit të kogjenerimit me termocentralin Kosova B, si burim alternativë për t'i mbuluar humbjet e nxehtësisë së qytetit të Prishtinës. Ky projekt ka përfshirë studimin e njësisë si të termocentralit Kosova B ashtu edhe të ngrohjes qendrore TERMOKOS. Në bazë të analizave është parë mundësia e marrjes së avullit nga të dy njësit e termocentralit Kosova B1 dhe B2, ku këtë marrje duhet dërguar tek nën-stacioni i dërgimit që do të ndërtohet si ndërtesë e re brenda lokacionit të TC Kosova B-së, e cila do t'i përfshin dy këmbyes të nxehtësisë me nga 70 MW_{et}, e cila do ta ngrohë ujin i cili vjen nga nën-stacioni i pranimit i vendosur në Prishtinë në një lokacion të ri brenda TERMOKOS-it, bartjen e ujit të cilin e mundëson pompa në vijën e gypave me gjatësi prej 12 km. Ky projekt tani më është funksional qysh pas implementimit të tij në vitin 2014 i cili ka treguar sukses.

Termocentrali Kosova B qysh në fillimin e ndërtimit të tij është paraparë vetëm si termocentral për prodhimin e energjisë elektrike, pa kogjenerim. Me implementimin e kogjenerimit në vitin 2014, është dashur që njësit e termocentralit Kosova B1 dhe B2 të ri-dizajnohen. Kjo nënkupton një sistem i tërë i ri, i cili në vete bart një arsenal të madh për funksionimin e tij që përfshin mirëmbajtjen e sistemit, ndikimin e tij në stabilimentet ekzistuese, në jetëgjatësinë e njësisë, etj.

Në këtë temë në mënyrë të përgjithshme do të shqyrtohen temat që kanë të bëjnë me sistemet e kogjenerimit për termocentrale të turbinave me kundërpresion dhe kondenzim, motorët me djegie të brendshme, përparësitë dhe mangësitë e këtij sistemi varësisht nga lloji i termocentralit, operimin dhe komandimin e tij, etj. Ndërsa në veçanti do të flitet për ndryshimin që ka sjell ky implementim i ri si sistemit të kogjenerimit në termocentralet Kosova B1 dhe B2, përkatësisht në rendimentin apo efikasitetin e tyre.

2. Bazat e kogjenerimit

2.1. Koncepti i kogjenerimit

Sistemet e kombinuara të nxehtësisë dhe energjisë apo Kogjenerimi (CHP – Combine Heat and Power), prodhojnë energjinë elektrike dhe atë termike në një sistem të vetëm të integruar. Kogjenerimi nuk është teknologji në vete, por një qasje e aplikimeve të teknologjive. Si energji të dobishme e konsideron nxehtësinë e cila normalisht nuk shfrytëzohet gjatë gjenerimit të energjisë elektrike. Kjo shmang humbjet të cilat do të ndodhnin si pasojë e prodhimeve të ndara të energjisë. Me zhvillimin e sistemeve të integruara të prodhimit të energjisë dhe nxehtësisë, sistemet e kogjenerimit janë më efikase se sa sistemet të ndara të energjisë dhe sigurojnë përfitime mjedisore, ekonomike dhe infrastrukturore të sistemit energjetik. Tek sistemet e kogjenerimit, energjia elektrike prodhohet në një vend ku nxehtësia e gjetur (e cila normalisht do të humbiste tek sistemet e ndara), do të shfrytëzohet për nxehtësi apo ftohje e një ndërtese aty pranë, ose për përdorim në proceset industriale.

Zhvillimet e fundit të teknologjive kanë “mundësuar” sisteme të reja të konfigurimit të kogjenerimit që e bën zbatimin e një sërë stabilimenteve me kosto – efektive. Gjeneratat e reja të turbinave, qelizave të lëndëve djegëse, si dhe motorëve me djegie të brendshme janë rezultat i përpjekjeve intensive, hulumtimeve bashkëpunuese, zhvillimeve dhe demonstrimeve nga qeveria dhe industria.

Prodhimi i zakonshëm i energjisë elektrike është në vetvete joefikas, duke konvertuar vetëm një të tretën e energjisë potenciale të lëndës djegëse në energji të dobishme. Rritja e ndjeshme e efikasitetit me anë të kogjenerimit rezulton në uljen përdorimit të lëndës djegëse dhe ul emetimin në krahasim me sistemet e ndara të prodhimit të nxehtësisë dhe energjisë. Kogjenerimi është një qasje ekonomikisht produktive për reduktimin e ndotësve të ajrit nëpërmjet parandalimit të ndotjes, ndërsa kontrolluesit e zakonshëm të ndotjes që arrihet vetëm me anë të trajtimeve kimike të produkteve të djegies nuk ofrojnë prodhimi fitimprurës dhe faktikisht ulin efikasitetin dhe prodhimin e energjisë së dobishme.

Siç u cek edhe më lartë, efikasiteti i këtyre sistemeve të kombinuara është shumë më i madh se sa i sistemeve të zakonshme të ndara, si p.sh. në figurën e paraqitur në vijim, sistemi i kogjenerimit ka një efikasitet prej 85%, përderisa ato të sistemeve të ndara kanë një efikasitet prej 45%. Dhe meqë

energjia prodhohet në një vend, humbjet e transmisionit dhe shpërndarjes (që zakonisht janë 7%) mënjanojnë.




Figura 2.1. Sistemi i ndarë dhe i kombinuar (sistemi kogjenerimit) për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike

Pasi që ka dy apo më shumë dalje të energjisë së dobishme nga sistemi i kogjenerimit, përcaktimi i efikasitetit të përgjithshëm të sistemit është më i ndërlikuar se sa i sistemeve të njëfishta. Sistemi mund të paraqitet si dy nënsisteme, sistemi energjisë (që zakonisht është motori apo turbina) dhe sistemi i rigjenerimit apo marrjes së nxehtësisë (që zakonisht është ndonjë tip i kaldajave apo këmbyesve).

Efikasiteti i përgjithshëm i sistemit rezulton nga një ndërveprim në mes të efikasitetit individual të sistemit të energjisë dhe sistemit të nxehtësisë së rigjeneruar (apo marrjes). Sistemet e kogjenerimit me efikasitet më të lartë (që arrijnë 80% të efikasitetit të përgjithshëm) janë ato që plotësojnë kërkesa të madhe termike duke prodhuar energji relativisht më pak. Sistemet e kombinuara apo kogjeneruese gjejnë përdorim të gjerë në industrinë e çelikut, kimit, letër, rafinerive të naftës, si dhe në kampuse të mëdha siç janë universitetet. Kohëve të fundit, sisteme të vogla të kogjenerimit kanë filluar të aplikohen edhe në industrinë e ushqimit, farmacisë, prodhuesit të ndriçuesve të ndryshme, ndërtesave komerciale, si dhe në institucione të vogla siç janë spitalet.

2.2. Variantet teknike të kogjenerimit

Teknologjitë në të cilat është shumë i përhapur përdorimi i kogjenerimit janë:

- Kogjenerimi në turbinat e avullit me kundërpresion dhe me kondenzim:
Këto operojnë me lëndë djegëse si qymyr guri, lignit, naftë, dru, mbeturina, nukleare. Avulli është mediumi në të cilën konvertohet energjia termike në atë mekanike.
- Kogjenerimi në turbinat me gaz:
Nafta dhe gazi janë lëndët djegëse të përshtatshme. Mediumi punues janë gazrat që dalin nga dhoma e djegies.
- Kogjenerimi në cikle të kombinuara:
Temperaturat e larta dhe përmbajtja e oksigjenit të gazit që del nga turbina me gaz, përdoret në procesin e dytë tek turbinat me avull.
- Kogjenerimi në motorët me djegie të brendshme:
Energjia kimike e gazit natyral apo e naftës gjatë djegies direkt shndërrohet energji mekanike.

Të gjitha këto teknologji të lartpërmendur janë në gjendje të prodhojnë si energjinë elektrike ashtu edhe atë termike dhe karakterizohen si “motor të nxehtësisë”. Motorët e nxehtësisë më konkretisht definohet si “*pajisje që konverton energjinë e nxehtësisë në energji mekanike*”. Për më shumë, funksionimi i një motori të nxehtësisë më së miri tregohet nga ciklet termodinamike. Disa shembuj janë si cikli Otto, Diesel, Brajton, Stirling dhe Rankin.

2.3. Sistemi i kogjenerimit të turbinës me avull

Dy llojet e turbinave me avull që kanë përdorim të gjerë janë turbinat me kundërpresion dhe turbinat me kondenzim me marrje të rregullueshme të avullit (*shih Figurën 2.2*). Zgjedhja midis turbinës me kundërpresion dhe asaj me kondenzim me marrje të rregullueshme kryesisht varet nga sasia e energjisë elektrike dhe e nxehtësisë, cilësisë së nxehtësisë dhe faktorëve ekonomik. Pikat e marrjes së avullit nga turbina mund të jenë më shumë se një, varësisht nga niveli i temperaturës së nxehtësisë që kërkohet nga procesi. Epërsia specifike e përdorimit të turbinave me avull në krahasim me ngasësit tjerë kryesorë është opsioni për përdorimin e një shumëllojshmërie të gjerë të lëndëve djegëse konvencionale si dhe alternative, si qymyri, gazi natyror, nafta dhe biomasa. Efiikasitetin e gjenerimit të energjisë të ciklit mund të sakrifikohet deri në një masë për të optimizuar furnizimin me ngrohje.




Figura 2.2. Skema e diagramit të dy llojeve të sistemit të kogjenerimit të turbinës me avull: (a) Turbina me kundërpresion dhe (b) Turbina me kondenzim me marrje të rregullueshme të avullit

Kogjenerimi tek impiantet me kundërpresion, nuk ka nevojë për kulla të mëdha ftohëse. Turbinat me avull përdoren kryesisht kur kërkesa për energji elektrike është më e madhe se një MW deri në disa qindra MW. Për shkak të inercionit të sistemit, operacioni i tyre nuk është i përshtatshëm për vendet me kërkesa të përhershme të energjisë.

Varësisht nga madhësia e turbinës, sasisë dhe kualitetit të avullit të kërkuar dhe nga faktorë tjerë të operues, ekzistojnë disa lloje të turbinave (shih Figurën 2.3): turbina e thjeshtë me kundërpresion, turbina me një apo me dy marrje me kundërpresion apo me kondenzim.




Figura 2.3. Llojet e turbinave me avull për sistemin e kogjenerimit: (a) kundërpresion i thjeshtë, (b) kundërpresion me një marrje të avullit, (c) kondenzim me dy marrje të avullit

2.4. Sistemi i kogjenerimit të turbinës me gaz

Sistemet e kogjenerimit tek turbinat me gaz mund të prodhojnë tërë ose një pjesë të energjisë sipas kërkesës së një vendi, ku energjia e cila lirohet në dalje me temperatura të larta në oxhak mund të rimerret për aplikime të ndryshme të ngrohjes dhe ftohjes (shih Figurën 2.4). Edhe pse gasi natyror përdoret më së shpeshti, lëndët djegëse tjera të tilla si vajra të lehta ose nafta gjithashtu mund të përdoren. Zona e prodhimit tek turbinat tipike me gaz ndryshon nga një pjesë e një MW në rreth 100 MW. Kogjenerimi i turbinës me gaz ka përjetuar ndoshta zhvillimin më të shpejtë në vitet e fundit për shkak të disponueshmërisë më të madhe të gazit natyror, përparimit të shpejtë të teknologjisë, reduktimit të ndjeshëm të kostove të instalimit dhe performancës më të mirë mjedisore.




Figura 2.4. Skema e diagramit të kogjenerimit të turbinës me gaz

Kogjenerimi i turbinës me gaz ka përjetuar ndoshta zhvillimin më të shpejtë në vitet e fundit për shkak të disponueshmërisë më të madhe të gazit natyror, përparimit të shpejtë të teknologjisë, reduktimit të ndjeshëm të kostove të instalimit dhe performancës më të mirë mjedisore. Për më tepër, periodha e përgatitjes për zhvillimin e një projekti është më e shkurtër dhe pajisjet mund të dorëzohen në mënyrë modulare.

Turbina me gaz ka një kohë të shkurtër të sinkronizimit dhe siguron fleksibilitetin në operim me ndërprerje. Nëse prodhimi i nxehtësisë është më i vogël se ai i kërkuar nga përdoruesi, ekziston mundësia që të bëhet djegie shtesë e gazit natyror duke shtuar lëndë djegëse plotësuese dhe duke përzier me gazin shkarkues që është i pasuruar me oksigjen, për të rritur prodhimin termik në mënyrë më efektive.

Në anën tjetër, nëse kërkohet më shumë energji elektrike në një vend, është e mundur që të përvetësohet cikli i kombinuar që është një kombinim i turbinës me gaz dhe i turbinës me avull. Avulli i prodhuar nga gazrat shkarkues të turbinës me gaz kalon përmes një turbine me avull me kundërpresion ose një turbine me kondenzim me marrje për të prodhuar energji elektrike shtesë. Shkarkimi ose avulli i nxjerrë nga turbina me avull, siguron energjinë termike të kërkuar.

2.6. Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e kogjenerimit

Skema e përzgjedhjes dhe operimit të një sistemi të kogjenerimit është shumë specifike dhe varet nga disa faktorë, siç përshkruhet më poshtë:

2.6.1. Përputhja e ngarkesës elektrike bazë

Në këtë konfiguracion, sistemi i kogjenerimit dimensionohet për të përmbushur kërkesën minimale të energjisë elektrike të një vendi bazuar në historikun e lakores së grafikut të shpenzimeve elektrike. Pjesa tjetër e energjisë së nevojshme është blerë nga rrjeti i shërbimeve.

Kërkesa për energji termike të një vendi mund të plotësohet vetëm nga sistemi i kogjenerimit ose nga kaldaja shtesë. Nëse energjia termike e prodhuar me ngarkesën elektrike bazë tejkalon kërkesën e centralit dhe nëse situata lejon, energjia e tepërt termike mund të eksportohet tek konsumatorët fqinjë.

2.6.2. Përputhja e ngarkesës termike bazë

Këtu, sistemi i kogjenerimit dimensionohet për të furnizuar minimumin e energjisë termike të një vendi. Kaldajat apo flak hedhësit që qëndrojnë në gatishmëri funksionojnë gjatë periudhave kur kërkesa për ngrohje është më e lartë.

Ngasësi kryesorë i instaluar funksionon me ngarkesë të plotë gjatë gjithë kohës. Nëse kërkesa për energji elektrike e një vendi tejkalon atë që mund të ofrohet nga ngasësi kryesor, atëherë kjo shtesë mund të blihet nga rrjeti. Po kështu, nëse ligjet lokale lejojnë, energjia elektrike e tepërt mund të shitet tek shërbimet e energjisë.

2.6.3. Përputhja e ngarkesës elektrike

Në këtë skemë operative, objekti është tërësisht i pavarur nga rrjeti i energjisë elektrike. Kërkesa e tërë e fuqisë së një vendi, duke përfshirë rezervat e nevojshme gjatë mirëmbajtjes së planifikuar dhe të paplanifikuar, duhet të merren parasysh gjatë dimensionimit të sistemit. Kjo gjithashtu referohet si një sistem "i pavarur".

Nëse kërkesa e energjisë termike e një vendi është më e lartë se ajo e prodhuar nga sistemi i kogjenerimit, përdoren kaldajat ndihmëse.

Nga ana tjetër, kur kërkesa për energji termike është e ulët, një sasi e energjisë termike humbet. Nëse ekziston mundësia, energjia e tepërt termale mund të eksportohet në objektet fqinje.

2.6.4. Përputhja e ngarkesës termike

Sistemi i kogjenerimit është projektuar për të përmbushur kërkesat e energjisë termike të një vendi në çdo kohë. Ngasësit kryesorë veprojnë sipas kërkesës termike. Gjatë periudhës kur kërkesa për energji elektrike tejkalon kapacitetin e prodhimit, deficitin mund të kompensohet me energjinë e blerë nga rrjeti. Në mënyrë të ngjashme, nëse ligji lokal lejon, energjia e tepërt elektrike e prodhuar mund t'i shitet ndërmarrjeve në çdo kohë.

2.7. Parametrat tipike të performancës së kogjenerimit

Tabela 2.1 e mëposhtme jep parametrat tipike të performancës së kogjenerimit për llojet e ndryshme të kogjenerimit duke dhënë shkallën e nxehtësisë, efikasitetin e përgjithshëm etj.

| Tabela 2.1 – Parametrat tipike të performancës së kogjenerimit | | | | | |
|---|----------------------------|--|---------------------|-----------------------------------|----------------------------|
| Ngasësi kryesorë të llojeve të kogjenerimit | Fuqia Nominale (Elektrike) | Shkalla e nxehtësisë së gjenerimit elektrik (kJ/kWh) | Efikasiteti, % | | |
| | | | Shndërrimi Elektrik | Marrja e nxehtësisë (rigjenerimi) | Kogjenerimi i përgjithshëm |
| Motorët më të vogël me djegie të brendshëm | 10 – 500 kW | 11088 – 12552 | 20 – 32 | 50 | 74 – 82 |
| Motorët më të mëdhenj me djegie të brendshëm | 500 – 3000 kW | 10042 – 13703 | 26 – 36 | 50 | 76 – 86 |
| Motorët Dizell | 10 – 3000 kW | 11590 – 15795 | 23 – 38 | 50 | 73 – 88 |
| Turbinat me gaz më të vogla | 800 – 10000 kW | 11590 – 14749 | 24 – 31 | 50 | 74 – 81 |
| Turbinat me gaz më të mëdha | 10 – 20 MW | 11590 – 13703 | 26 – 31 | 50 | 78 – 81 |
| Turbinat me avull | 10 – 100 MW | 10544 – 21087 | 17 – 34 | – | – |

Shënim: Këto të dhëna janë marr nga “Cogeneration Handbook California Energy Commission, 1982”

2.8. Meritat relative të sistemeve të kogjenerimit

Tabela 2.2 e mëposhtme jep përparësitë dhe mangësitë e sistemeve të ndryshme të kogjenerimit.

| Tabela 2.2 - Përparësitë dhe mangësitë e sistemeve të ndryshme të kogjenerimit | | |
|---|--|---|
| Sistemi | Përparësitë | Mangësitë |
| Turbinat e avullit me kundërpresion | <ul style="list-style-type: none"> • Shkallë të lartë të efikasiteti të lëndës djegëse | <ul style="list-style-type: none"> • Pak fleksibilitet në dizajnë dhe operim |
| Turbinat e avullit me kondenzim | <ul style="list-style-type: none"> • Impiant i thjeshtë, • I përshtatshëm për lëndë djegëse me cilësi të ulët. | <ul style="list-style-type: none"> • Më shumë investime kapitale, • Shkallë e ulët e efikasitetit të lëndës djegëse, • Kërkesë të lartë e ujit për ftohje, • Më shumë ndikim në mjedis, • Ndërtime me kosto të larta për shkak të themeleve të komplikuar. |
| Turbinat me gaz | <ul style="list-style-type: none"> • Efikasitet i mirë i lëndës djegëse • Impiant i thjeshtë • Ndërtim me kosto të ulët, • Më pak periudhë të shpërndarjes, • Më pak ndikim në mjedis, • Fleksibilitet i lartë në operim. | <ul style="list-style-type: none"> • Efikasiteti mesatar i ngarkesës së pjesëve, • E kufizuar për lëndë djegëse të përshtatshme me cilësi të ulët |
| Turbinat e kombinuara me gaz dhe avull | <ul style="list-style-type: none"> • Shkallë optimale të efikasitetit të lëndës djegëse, • Kosto relativisht e ulët kapitale • Periudhë më pak përgatitore, • Nisje dhe ndërprerje e shpejtë, • Më pak ndikim në mjedis • Fleksibilitet i lartë në operim, | <ul style="list-style-type: none"> • Efikasiteti mesatar i ngarkesës së pjesëve, • Përshtatshmëria e kufizuar për lëndë djegëse me cilësi të ulët |
| Motorët me djegie të brendshëm | <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtim me kosto të ulët, • Efikasitet të lartë të energjisë, • Përshtatshmëria më e mirë për burime të ndryshme të energjisë, | <ul style="list-style-type: none"> • Efikasitet të përgjithshëm të ulët, • Përshtatshmëria e kufizuar për lëndë djegëse me cilësi të ulët • Disponueshmëria e avullit me temperaturë të ulët, • Mirëmbajtje me kosto të lartë, |

2.9. Politikat e shpërndarjes së energjisë

Ndonëse teknologjitë që përdoren në sistemet kogjeneruese janë përmirësuar në vitet e fundit dhe kogjenerimi ka një kosto efektive të përdorimit, pengesat legislative prapë janë ato të cilat e kufizojnë shpërndarjen e gjerë të kogjenerimit. Një barrierë e madhe e sistemeve kogjeneruese është mungesa e praktikave standarde të bizneseve kombëtare për interkoneksionin e teknologjive gjeneruese shpërndarëse në rrjetin lokal të energjisë elektrike (Interkoneksion është proces i lidhjes së sistemit të kogjenerimit, ose ndonjë burimi të shpërndarjes së energjisë, në rrjetin transmetues dhe të shpërndarjes).

Kjo mungesë e praktikave standarde të njëtrajtshme të bizneseve rezulton në një larmi të modeleve rregullative. Disa ndërmarrje kërkojnë studime të kushtueshme dhe komplekse si dhe instalim të pajisjeve të shtrenjta të panevojshme që të bëj të pavlerë sistemin e kogjenerimit. Shumë ndërmarrje gjithashtu aktualisht paguajnë *tarifa diskriminuese* dhe i ndalojnë nga "ikja nga tarifat" për konsumatorët që përdorin kogjenerimit në objektet ekzistuese.

Rregullatorët e emisioneve që aktualisht janë në fuqi, gjithashtu përbëjnë një pengës për sistemet kogjeneruese pasi që nuk e njohin efikasitetin e përgjithshëm të energjisë së sistemeve kogjeneruese.

Qasja aktuale e rregullativit mbështetet në një standard të bazuar në të dhëna hyrëse, i cili mat emetimet si masë të ndotësve për BTU të karburantit hyrës, duke kalkuluar futjen e karburantit në një termocentral tipik në baza të marrëdhënieve tradicionale. Kjo metodë nuk merr parasysh produktin e dobishëm termik që ofron një sistem i kogjenerimit në dalje. Kjo nuk arrin në mënyrë të përshtatshme të llogarisë efikasitetin e sistemit dhe përjashton përfitimet që vijnë nga sistemi i kogjenerimit. Nga ana tjetër, standardet e bazuara në prodhim lidhin emetimet me prodhimin përfundimtarë të dobishëm në dalje të gjeneratorit. Kjo qasje i shpërblen gjeneratorët që kanë "prodhim" të lartë të megavateve për orë dhe që kanë "dalje" më të ulët të ndotësve.

Standardet e bazuara në prodhim llogarisin emetimet në bazë të sasisë së energjisë elektrike të prodhuar, që mund të paraqitet si kilogramë të ndotësve për megavat orë. Përdorimi i matjeve në dalje të prodhimit bën që të nxis efikasitet më të madh të energjisë dhe reduktim të ndotjes, duke reduktuar ndikimin mjedisor të sektorit të energjisë duke rritur sasinë e energjisë në dispozicion në SHBA.

EPA amerikane ka dhënë udhëzime për zbatimin e rregullave të bazuara në prodhim, por deri në kohët e fundit vetëm 17 shtete kanë miratuar këtë qasje rregullative.

2.10. Termocentrali Kosova B dhe sistemi i kogjenerimit në termocentrali Kosova B

2.10.1. Historiku i shkurt i investimeve në Termocentralin Kosova B

Termocentrali Kosova B përbëhet nga dy njësi prodhuese, pra TC Kosova B1 i cili ka filluar prodhimin e energjisë elektrike në vitin 1983 dhe TC Kosova B2 i cili ka filluar prodhimin e energjisë elektrike në vitin 1984. Gjatë gjithë këtyre viteve të kaluara e deri më tani, me zhvillimin e teknologjisë edhe këto termocentrale kanë pësuar ndryshime duke bërë zbatimin e projekteve të reja, në mënyrë që të arrijnë një mirëqenie sa më të qëndrueshme dhe të sigurve të punës si dhe gjithnjë duke tentuar rritjen e efikasitetit të punës.

Në vitin 2002, të dy njësitë e termocentralit Kosova B pësuan një incident të rëndë, ku si pasojë e flakës së shkaktuar nga vetëtima bëhet djegia e dhomave komanduese të termocentralit B1 dhe B2 së bashku me të gjithë pajisjet që mundësojnë operimin, e po ashtu edhe pajisje tjera. Kostoja për riparim që ka sjell ky incident ka qenë shumë e lartë, diku rreth 50-60 milion EUR. Ky incident ka shkaktuar humbje në të dy anët, pra në njërin anë shpenzime të mëdha për riparimin e pjesëve të dëmtuar dhe në anën tjetër mos pasjen e të ardhurave nga mos shitja e energjisë elektrike deri në përfundim të riparimit.

Kjo kohë është shfrytëzuar që të bëhet modernizimi i dhomave të komandimit në një sistem digjital e të kompjuterizuar shumë të avancuar, në ndërrimin komplet të stabilimenteve elektrike të 0.4 kV dhe 6 kV të bllokut B1 me stabilimente të reja të teknologjisë më bashkëkohore, i cili ka ndikuar shumë në lehtësimin e punëve në operim/komandim dhe menaxhim të situatave më mirë si dhe ka rritur nivelin e sigurisë në punë.



a)



b)



c)

Figura 2.6. Dhoma e komandimit në TC Kosova B: a) para incidentit, b) pas incidentit, c) pas investimeve

Disa nga projektet e tjera të mëdha që mund të i quajmë si modernizim të sistemeve janë si:

- Transporti i hirit që është bërë me anë të shiritave ajo tani bëhet me anë të sistemit të ri hidraulik. Ky projekt ka ndikuar pozitivisht duke eliminuar pluhurin e madh në lokacionet të banuara përreth shiritave e po ashtu edhe të mirëmbajtjes.
- Modernizimin komplet të sistemit të elektrolizës si nga pajisjet ashtu edhe nga ana e komandimit të saj gjë që ka lehtësuar shumë punën në mirëmbajtje/komandim të saj e po ashtu edhe në rritjen e sigurisë më të madhe të prodhimit të H₂.
- Aplikimi i sistemin për matjen on-line të emisioneve të gazrave në oxhakun e termocentralit.
- Aplikimi i sistemit të kogjenerimit për nevojat e ngrohjes për qytetin e Prishtinës, etj.



a)

b)

c)

Figura 2.7. Projektet e reja të sistemeve të ndryshme në TC Kosova B: a) sistemi i vjetër i elektrolizës, b) sistemi i ri i elektrolizës, c) aplikimi i sensorëve për matjen e emisioneve në atmosferë në oxhakun e TC Kosova B

TC Kosova B është e llojit me kondenzim të avullit, ku avulli pas zgjerimit në turbinë hyn në kondenzatorë në të cilin bëhet ndërrimi i gjendjes agregate nga avull uji në ujë.

Si lëndë djegëse TC Kosova B përdorë thëngjillin apo linjitin, ndërsa gjatë startimit apo kur nuk janë në funksion mullinjte e thëngjillit përdoret edhe mazuti. Stabilimentet tjerë kryesor të TC Kosova B janë:

- Kaldaja e avullit e cila është me rrymim apo qarkullim të detyruar,
- 8 mullinj të thëngjillit apo linjtit,
- 2 ventilatorë për futje e ajrit në kaldajë dhe 2 ventilatorë për thithjen e gazrave të prodhuara nga kaldaja,
- Turbina e presionit të lartë, mesëm dhe ulët e avullit, boshtet e të cilave janë të lidhura në mes veti me lidhje të ngurtë,
- Gjeneratori elektrik,
- Kondenzatori,
- Kulla ftohëse dhe 2 pompa të qarkullimit të ujit për ftohje,
- 2 pompa të kondensimit,
- Nxehtësit regjenerativ të presionit të ulët nr. 1, 2 dhe 3 dhe të presionit së lartë nr. 5 dhe 6,
- De-ajrimi dhe rezervuari (që konsiderohet edhe si nxehtësi nr. 4) i pompave furnizuese, dhe
- Pompat furnizuese nr. 1, 2 dhe 3.

2.10.2. Projekti i kogjenerimit në termocentralin Kosova B

Termocentrali TC Kosova B siç shihet edhe më lartë, është ndërtuar pa projektin e kogjenerimit.

Projekti i kogjenerimit në TC Kosova B për nevojat e ngrohjes së qytetit të Prishtinës ka filluar të aplikohet qysh në mesin e vitit 2014, pra si qëllim është shfrytëzimi i nxehtësisë nga marrja e avullit nga të dy njësitë ekzistuese të TC Kosova B1 dhe Kosova B2 dhe transmetimi i kësaj nxehtësie në sistemin e ngrohjes qendrore të Prishtinës nëpërmjet gypave me gjatësi 12 km.

I gjithë projekti i kogjenerimit mund të themi se përbëhet nga këto seksionet e mëposhtme:

- Marrja e avullit nga termocentrali Kosova B,
- Stacionit i këmbyesve të nxehtësisë (apo nënstacioni i dërgimit të nxehtësisë) nga marrja e avullit, këmbyesit e nxehtësisë 2 x 70 MW energji termike,
- Transportimi i nxehtësisë nga nënstacioni i dërgimit TC Kosova B (Obiliq), në stacionin e pranimit TERMOKOS (Prishtinë) nëpërmjet gypave,
- Nënstacioni i pranimit të nxehtësisë,
- Shpërndarja e nxehtësisë nga kaldaja e Termokos-it në nënstacionet tjera ekzistuese nëpërmjet pompave të rrjetës ekzistuese.

Për të arritur vlerat projektuese të ngarkesës së njërit këmbyes të nxehtësisë prej 70 MWet me temperaturë të dërgimit për në Prishtinë 120 °C dhe të kthimit nga Prishtina rreth 70 °C, parametrat e avullit që merret nga njëra njësi TC Kosova B1 ose B2 që hyn në këmbyes duhet të jenë me temperaturë 192 °C, presion 2.5 bar, dhe sasi të avullit 28 kg/s ose 100.8 t/h.

Në kontekst të përmirësimit të sistemit të furnizimit me ngrohje qendrore për qytetin e Prishtinës, ALSTOM Power u angazhua për të shqyrtuar raste të ndryshme të marrjes së nxehtësisë nga turbina me avull e prodhuesit MAN të instaluar në termocentralin Kosova B.

Bazuar në diagramet referente të bilancit termik, humbjet e prodhimit të energjisë elektrike për shkak të marrjes së avullit për ngrohje qendrore janë llogaritur për tri raste të marrjes së nxehtësisë. Më vonë këto tri raste janë shqyrtuar dhe krahasuar nga pikëpamja termodinamike (humbjet e energjisë elektrike) dhe nga pikëpamja dizajnit të turbinës. Së fundi rezultatet janë përmbledhur dhe përfundimet janë dhënë.

2.10.3. Diagramet referente të bilancit termik për mënyrën e operimit të kondensimit

Sipas propozimit të ALSTOM-it për Shërbimet e Konsulencës dhe një marrëveshje të mëvonshme ndërmjet klientit Energiecounseling Heidelberg International GmbH dhe ALSTOM-it tri rastet e më poshtme të ngarkesës shërbejnë si ngarkesa referente të mënyrës së operimit të kondensimit dhe diagramet përkatëse të bilancit termik janë llogaritur në përputhje me to. Në vijim janë paraqitur këto rastet e studimit:

- Ngarkesa maksimale elektrike, **339 MW** (mbingarkesë) që korrespondon me 107 % të rrjedhjes kryesore të avullit (1000 t/h), Avulli i freskët: 177 bar / 540 °C, Avulli i ri-tejnxehur: 540 °C, Hyrja e ujit ftohës: 23 °C,
Diagrami i bilancit termik nr.: TSCE/12/000.002
- Ngarkesa nominale elektrike, **315 MW** që korrespondon me 100 % të rrjedhjes kryesore të avullit (909 t/h), Avulli i freskët: 177 bar / 540 °C, Avulli i ri-tejnxehur: 540 °C, Hyrja e ujit ftohës: 23 °C,
Diagrami i bilancit termik nr.: TSCE/12/000.001
- Ngarkesa minimale elektrike, **189 MW** që korrespondon me 60 % të rrjedhjes kryesore të avullit, Avulli i freskët: 540 °C, Avulli i ri-tejnxehur: 540 °C, Hyrja e ujit ftohës: 23 °C,
Diagrami i bilancit termik nr.: TSCE/12/000.001

2.10.4. Shqyrtimi nga aspekti termodinamik i tre rasteve për furnizimin me ngrohje qendrore

Në studimin inxhinierik, janë marr parasysh të tre rastet për ngrohje qendrore. Në vijim janë paraqitur një përshkrim i shkurt i këtyre rasteve:

- **A1:** Marrja e avullit për furnizimin me ngrohje qendrore vetëm në drejtim të rrymës në dalje të Turbinës së Presionit të Mesëm (TPM) nga tubat ndërlidhëse në mes të TPM-së dhe TPU-së (Turbinës së presionit të ulët).
Për këtë rast nevojitet 1 këmbyes i nxehtësisë.
- **A2:** Marrja e avullit për furnizimin me ngrohje qendrore në drejtim të rrymës në dalje të TPM-së nga tubat ndërlidhëse në mes të TPM-së dhe TPU-së dhe gjithashtu në pikën e marrjes së avullit ekzistuese në TPU që shkon për ngrohje regjenerative nr. 1 (Nxehtësi i Presionit të Ulët nr.1 – NPU-1).
Për këtë rast nevojiten 2 këmbyes të nxehtësisë.
- **A3:** Marrja e avullit për furnizimin me ngrohje qendrore në drejtim të rrymës në dalje të TPM-së nga tubat ndërlidhëse në mes të TPM-së dhe TPU-së dhe gjithashtu në ndonjë dalje që nuk ekziston e marrjes në TPU (në drejtim të rrymës së TPU-së në shkallën 1).
Për këtë rast nevojiten 2 këmbyes të nxehtësisë.

Vlerat termodinamike të këtyre rasteve A1, A2 dhe A3 janë kontrolluar me anë të kalkulimeve të bilancit termik lidhur me pikat e ngarkesave “Ngarkesa Elektrike Nominale” dhe “Ngarkesa Elektrike Minimale” secila e lidhur me prodhim për ngrohje qendrore me 140, 70 dhe 35 MW. Për secilin rast sistemi i ngrohjes qendrore është i dizajnuar për 140 MWet. Po ashtu, supozimet e mëposhtme janë marr parasysh në projektimin e sistemit të ngrohjes qendrore:

- Rënia e presionit në sistemin e gypit marrës: 5 %
- Diferenca e temperaturës përfundimtare e pjesës së kondensuar të secilit këmbyes të nxehtësisë: 5 K
- Diferenca e temperaturës përfundimtare e pjesës së tejkthjes të secilit këmbyes të nxehtësisë: 6 K

Për të gjitha llogaritjet e bilancit të termik të lartpërmendur, temperatura e dërgimit dhe e kthimit të sistemit të ngrohjes qendrore është përvetësuar në 120 °C respektivisht 73 °C.

Rezultatet në lidhje me humbjen e prodhimit të energjisë elektrik janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme (Tabela 2.3).

Tabela 2.3 – Rezultatet e përmbledhura të bilancit termik të diagrameve për rastet A1, A2 dhe A3

| Përshkrimi | Rasti | Energjia termike e këmbysesit të nxehtësisë [MWet] | Energjia Elektrike [kW] | Energjia Elektrike Referente [kW] | Humbjet e Energjisë Elektrike [kW] |
|--------------------------------------|-------|--|-------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| Ngarkesa Nominale Elektrike | Ref. | 0 | 316595 | 316595 | 0 |
| Ngarkesa Nominale, 140 MW Ngro. Qen. | A1 | 140 | 294132 | 316595 | 22463 |
| Ngarkesa Nominale, 140 MW Ngro. Qen. | A2 | 140 | 296138 | 316595 | 20457 |
| Ngarkesa Nominale, 140 MW Ngro. Qen. | A3 | 140 | 298743 | 316595 | 17852 |
| | | | | | |
| Ngarkesa Nominale, 70 MW Ngro. Qen. | A1 | 70 | 307102 | 316595 | 9493 |
| Ngarkesa Nominale, 70 MW Ngro. Qen. | A2 | 70 | 308097 | 316595 | 8498 |
| Ngarkesa Nominale, 70 MW Ngro. Qen. | A3 | 70 | 308454 | 316595 | 8141 |
| | | | | | |
| Ngarkesa Nominale, 35 MW Ngro. Qen. | A1 | 35 | 311782 | 316595 | 4813 |
| Ngarkesa Nominale, 35 MW Ngro. Qen. | A2 | 35 | 312494 | 316595 | 4101 |
| Ngarkesa Nominale, 35 MW Ngro. Qen. | A3 | 35 | 312581 | 316595 | 4014 |
| | | | | | |
| Ngarkesa Minimale Elektrike | Ref. | 0 | 189007 | 189007 | 0 |
| Ngarkesa Nominale, 140 MW Ngro. Qen. | A1 | 140 | 155276 | 189007 | 33731 |
| Ngarkesa Nominale, 140 MW Ngro. Qen. | A2 | 140 | 154200 | 189007 | 34807 |
| Ngarkesa Nominale, 140 MW Ngro. Qen. | A3 | 140 | 153851 | 189007 | 35156 |
| | | | | | |
| Ngarkesa Nominale, 70 MW Ngro. Qen. | A1 | 70 | 170009 | 189007 | 18998 |
| Ngarkesa Nominale, 70 MW Ngro. Qen. | A2 | 70 | 169688 | 189007 | 19319 |
| Ngarkesa Nominale, 70 MW Ngro. Qen. | A3 | 70 | 171781 | 189007 | 17226 |
| | | | | | |
| Ngarkesa Nominale, 35 MW Ngro. Qen. | A1 | 35 | 177356 | 189007 | 11651 |
| Ngarkesa Nominale, 35 MW Ngro. Qen. | A2 | 35 | 177124 | 189007 | 11883 |
| Ngarkesa Nominale, 35 MW Ngro. Qen. | A3 | 35 | 181438 | 189007 | 7569 |

Bazuar në rezultatet të paraqitura në tabelën në vijim (Tabela 2.3), mund të thuhet se rasti A3 rezulton në pothuajse në të gjitha rastet me humbje më të vogël të energjisë elektrike dhe do të ishte zgjidhja më e mirë nga pikëpamja termodinamike. Në anën tjetër, mund të shihet se rasti A2 (gjithashtu edhe rasti A3 në një kalkulim) arrin humbjet më të mëdha në ngarkesë minimale. Gjatë operimit me ngarkesë minimal presioni në marrje të TPU-së bie shumë shpejt kështu që nuk mund të zë vend kondenzimi në këmbyesin e nxehtësisë nr. 1. Kjo do të thotë se këmbyesi nr. 1 nuk do të punoj. Në mënyrë që të arrij ngrohjen e kërkuar të ujit të ciklit të ngrohjes qendrore, këmbyesi nr. 2 duhet të siguroj komplet ngrohjen e ujit dhe kështu të operoj me tej ngarkesë. Kjo rezulton në diferencë të mëdha permanente të temperaturës si dhe rënie të presioneve të mëdha përgjatë gypave të marrjes së avullit dhe për shkak të kësaj jep rendiment të dobët.

2.10.5. Shqyrtimi nga aspekti i dizajnit të turbinës i tre rasteve për furnizimin me ngrohje qendrore

Duke u bazuar në rezultatet të kalkulimeve të bilancit termik për 140 MW energji termike të këmbyesit dhe duke supozuar shpejtësinë maksimale të avullit 60 m/s, janë përcaktuar diametrat e gypave të marrjes së avullit. Më pas është kontrolluar, se si ti vendosim këto gypa shtesë rreth dhe mbi turbinë. Rezultatet për rastet A1, A2 dhe A3 janë dhënë si më poshtë:

- **A1:** Duhet të ketë valva rregulluese në gypin ndërmjetësues të TPM-së dhe TPU-së, kjo do të thotë se duhet një ri-dizajn i gypave ndërmjetësues dhe mbajtësve të këtyre gypave. Gypat e ri të marrjes së avullit duhet të lidhen në gypin dalës të TPM-së, ku gjithashtu edhe për këtë pjesë nevojiten dizajn i ri i armaturës së gypave.
- **A2:** Hapësira unazore ekzistuese në pikën e marrjes së TPU-së është projektuar për të furnizuar me avull nxehtësinë TU nr.1 dhe nuk mund të rritet. Kjo do të thotë se gypat e ri të marrjes së avullit duhet të depërtojnë përmes kësaj hapësire unazore dhe do të rezultojë me shpejtësi të madhe e të papranueshme (më shumë se 130 m/s).
- **A3:** Hapësira ekzistuese aksiale në mes të shkallëve nr. 1 dhe 2 të TPU-së është shumë e vogël dhe nuk lejon të pajis shtëpizën e brendshme të TPU-së me gypa të mëdha të marrjes.

Duke marr parasysh këto rezultate mund të vijmë në përfundim se rasti A2 dhe A3 duhet të përjashtohen për shkak të faktorit të dizajnit të turbinës dhe vetëm rasti A1 duhet të merret parasysh në projektim të mëtutjeshëm.

2.10.6. Përmbledhjet e shqyrtimeve nga aspekti termodinamik dhe të dizajnit të turbinës

Shqyrtimi termodinamik duke u bazuar në këtë raport tregon se rasti A3 rezulton me humbje më të vogël të energjisë elektrike dhe do të ishte zgjidhja më e mirë nga pikëpamja termodinamike. Në anën tjetër, rasti A2 dhe A3 nuk janë të zbatueshme për shkak të konsideratës së dizajnit të turbinës.

Për këtë ALSTOM Power ka rekomanduar që të ndiqet rasti A1 në projektin e ardhshëm të ekzekutimit, që do të thotë:

- **Rasti A1:** Marrja e avullit për furnizimin me ngrohje qendrore vetëm në drejtim të rrymës në dalje të Turbinës së Presionit të Mesëm (TPM) nga tubat ndërlidhëse në mes të TPM-së dhe TPU-së (Turbinës së presionit të ulët) dhe me një stacion të sistemit të ngrohjes me vetëm një këmbyes të nxehtësisë.

Pra siç shihet më lart me anë të analizave të ALSTOM Power është ardhur në përfundim që si zgjidhje optimale do të ishte ngrohja me anë të avullit që do të merrej nga avullsjellësi në mes të turbinës së shtypjes së mesme dhe turbinës së shtypjes së ulët.

Stacioni i këmbyesve (apo nënstacioni i dërgimit) të sistemit të kogjenerimit është i vendosur në një objekt të veçantë në mënyrë që të bëhet e mundur vendosja sa më e lehtë e pajisjeve të nevojshme, siç janë: këmbyesit, gyp-sjellësit, valvat e ndryshme, sistemi i kondenzatit, rezervuarët si dhe pompat për dërgimin e ujit të ngrohtë.

Në nënstacion janë të vendosura edhe pajisjet tjera përcjellëse, siç janë: sistemi i rregullimit, komandimit, matjeve, mbrojtjeve si dhe i furnizimit me energji elektrike. Në vijimi janë paraqitur skemat e marrjes nga termocentrali Kosova B.




Figura 2.8. Skema e thjeshtë marrjes së avullit për kogjenerim nga turbina e termocentralit Kosova B1 dhe B2 për Prishtinë




Figura 2.9. Skema bazike e marrjes së avullit për kogjenerim nga Turbina e Kosovës B1 dhe B2 për Prishtinë

ANALIZA E EFIKASITETIT TË NJËSIVE TË TERMOCENTRALIT "KOSOVA B" PARA DHE PAS INSTALIMIT TË KOGJENERIMIT




Figura 2.10. Skema funksionale e ndërtesës së nënstacionit të këmbësoris nr.1 dhe nr. 2 (2 x 70 MWet) në TC Kosova B




Figura 2.11. Pamje në vend nga marrja e avullit në TC Kosova B




Figura 2.12. Paraqitja 3D në pikat e marrjes së avullit në termocentralit Kosova B




Figura 2.13. Skema e marrjes së avullit për ngrohjen e qytetit të Prishtinës në sistemin e monitorimit të TC Kosova B-së (sistemi i kogjenerimit)

Siç është cekur edhe më lartë, pikat e marrjes së avullit për sistemin e kogjenerimit për ngrohjen e qytetit të Prishtinës janë në të dy anët e daljes të TPM-së. Në mënyrë që sasia e nevojshme e rrymimit të avullit të drejtohet kah gypat e marrjes për në nënstacionin e këmbyesve, është nevojitur që të bëhet vendosja e valvave rregulluese “Flutur” DN 1200 në të dy gypat të avujsjellësit në dalje të TPM-së përkatësisht pas pikave të marrjes së avullit dhe para hyrjes në TPU. Me anë të këtyre valvave rregulluese “flutur” mundësohet rregullimi i sasisë dhe shtypja e avullit, e mjaftueshme për të ngrohur ujin në këmbyesit e nxehtësisë në një temperaturë të nevojshme dhe të mjaftueshme për sistemin e kogjenerimit përkatësisht për të plotësuar kërkesat e TERMOKOS-it për ngrohjen e qytetit të Prishtinës. Më poshtë është paraqitur dukja e kësaj valve “Flutur”.




Figura 2.14. Valvat rregulluese “Flutur” DN 1200 të vendosura në dy daljet e TPM-së përkatësisht pas pikave të marrjes së avullit dhe para hyrjes në TPU

3. Parametrat projektues dhe punues të termocentralit Kosova B dhe të sistemit të kogjenerimit

Duke marr parasysh se termocentrali Kosova B1 është identik me termocentralin Kosova B2, atëherë çdo parametër e paraqitur në vijim është e njëjtë si për njësinë (bllokun) B1 ashtu edhe për njësinë B2 që do t'i referohemi si parametër i termocentralit Kosova B.

Në vijim janë të paraqitura tabelat e parametrave projektues dhe punues para dhe pas instalimit të kogjenerimit në termocentralit Kosova B për ngarkesë minimale apo siç thuhet edhe ndryshe minimumi teknik me fuqi **189 MW**, ngarkesë projektuese me fuqi **252 MW**, ngarkesë nominale me fuqi **315 MW** dhe ngarkesë maksimale apo maksimumi teknik me **339 MW** si dhe do të merren dy raste me ngarkesë punuese të ndryshme nga ai projektues për ngarkesë me fuqi **230 MW** dhe **295 MW**.

3.1. Parametrat projektues dhe punues të termocentralit Kosova B para instalimit të kogjenerimit

Turbina e TC Kosova B është prodhuar nga kompania MAN, Gjermani. Turbina është me tre shtëpiza, boshtet e rotorëve të cilat janë të lidhura me lidhje të ngurtë e që cilësohet si turbinë njëboshtore.

Turbina është e tipit me kondensim me marrje të avullit për ngrohjen regjenerative të ujit që kalon në nxehtësit e shtypjes së ultë (3 këmbyes) dhe nxehtësit e shtypjes së lartë (2 këmbyes), po ashtu edhe një në rezervuarin furnizues (*Figura 3.1*).




Figura 3.1. Marrjet e avullit nga turbina e TC Kosova B. TPL, TPM, TPU – turbina e presionit të lartë, të mesëm dhe e presionit të ulët; Gja – gjeneratori i avullit; TE, RT – tejnxehtësi dhe ritejnxehtësi.

Kjo turbinë për nga forma është turbinë aksiale me zgjerim të avullit në diza dhe me shkallë të vogël të reaktivitetit që do të thotë se avulli në këtë turbinë zgjerohet kryesisht në diza. Turbina e presionit të lartë i ka 12 shkallë dhe një marrje regjenerative të avullit. Turbina e presionit të mesëm i ka 12 shkallë dhe katër marrje të avullit nga të cilat marrja të avullit në pikën C është marrje e avullit të ujit për rezervuarin furnizues respektivisht në de-ajrim për largimin e gazrave në rezervuarin furnizues. Turbina e presionit të ulët i ka 2x5 shkallë, dhe vetëm një marrje për ngrohje regjenerative të ujit.

Ndërmjet turbinës së presionit të lartë dhe turbinës së presionit të mesëm është ri-tejnxehja e avullit të ujit, ku avulli pasi të kryen punën e vet në turbinën e presionit të lartë kalon në kaldajë për tu ri-tejnxehur dhe më pas kthehet në turbinën e presionit të mesëm dhe vazhdon kështu edhe në turbinën e presionit të ulët.

Në tabelën 3.1 dhe 3.2 në vijim janë të paraqitura e parametrave projektues të termocentralit Kosova B për ngarkesë minimale apo siç thuhet edhe ndryshe minimumi teknik me fuqi **189 MW**.

| Parametrat në Turbinë | TPL | | TPM | | TPU | |
|------------------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|---------------------|----------------|
| | Hyrje | Dalje | Hyrje | Dalje | Hyrje | Dalje |
| Temperatura [$^{\circ}\text{C}$] | $t_1 = 540$ | $t_2 = 331.9$ | $t_3 = 540$ | $t_4 = 215$ | $t_{4=5} = 215$ | $t_6 = 31.4$ |
| Presioni [bar] | $p_1 = 104.8$ | $p_2 = 24.45$ | $p_3 = 22$ | $p_4 = 1.852$ | $p_{4=5} = 1.852$ | $p_6 = 0.046$ |
| Entalpia [kJ/kg] | $i_1 = 3471.85$ | $i_2 = 3086.56$ | $i_3 = 3554.73$ | $i_4 = 2901.58$ | $i_{4=5} = 2901.58$ | $i_6 = 2412.4$ |
| Prurja [kg/s] | $m_1 = 147.34$ | $m_2 = 146.2$ | $m_3 = 138.51$ | $m_4 = 121.14$ | $m_5 = 114.39$ | $m_6 = 106.38$ |

| Parametrat në Pikat e Marrjes | A | B | C | D | E | G |
|------------------------------------|-----------------|-----------------|------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| | NTL 6 | NTL 5 | Rezervuari Furnizues 4 | NPU 3 | NPU 2 | NPU 1 |
| Temperatura [$^{\circ}\text{C}$] | $t_A = 331.9$ | $t_B = 463.1$ | $t_C = 358.9$ | $t_D = 297.2$ | $t_E = 215.0$ | $t_G = 108.5$ |
| Presioni [bar] | $p_A = 24.45$ | $p_B = 12.97$ | $p_C = 6.189$ | $p_D = 3.796$ | $p_E = 1.852$ | $p_G = 0.5434$ |
| Entalpia [kJ/kg] | $i_A = 3086.56$ | $i_B = 3395.64$ | $i_C = 3184.31$ | $i_D = 3061.89$ | $i_E = 2901.58$ | $i_G = 2698.63$ |
| Prurja [kg/s] | $m_A = 7.686$ | $m_B = 8.038$ | $m_C = 4.0$ | $m_D = 5.326$ | $m_E = 6.823$ | $m_G = 8.694$ |

Principi i punës së termocentralit Kosova B për ngarkesë 189 MW energji elektrike sipas vlerave projektuese është: Avulli i ujit me sasi 147.34 kg/s, me presion 104.8 bar dhe temperaturë 540°C hyn në turbinën e presionit të lartë duke kaluar nëpër shkallët e turbinës, e lëvizë turbinën dhe vetë ai zgjerohet duke iu zbritur presioni gjerë në vlerën $p = 24.45$ bar dhe temperaturë $t = 331.9$ °C ku një sasi e këtij avulli me këta parametra merret për marrje 6 apo pika A në rastin tonë që kalon në këmbyesin e nxehtësisë numër 6 (NTL 6) për nxehjen regjenerative të ujit furnizues me një sasi të avullit prej 7.686 kg/s, më pastaj avulli kalon në kaldajë në pjesën e ri-tejnxehjes për tu ri-tejnxehur.

